

KONTRATË
SHIT – BLERJE KUOTE

Sot, më datë 15.10.2020 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën Shitësit dhe Blerësi, të cilët ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate me termat e mëposhtme:

SHITËSI:

Renis Haxhia, shtetas shqiptar, i biri i Maksimit dhe i Etlevës, i lindur më 14.07.1989, në Tiranë, banues në adresën Zibrak, rruga Kuvajt, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit Nr. 025325595 dhe numër personal I90714072M.

Seman Sunpower SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër NIPT K81722018P, me seli të regjistruar në adresën Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Murat Toptani, (Pedonalja e Tiranës), ndërtesa Eurocol përballë Kalasë së Tiranës, kati 7, përfaqësuar sipas vendimit të asamblesë të datës 13.10.2020 nga ana e administratores, Znj. Orkida Rama, shtetase shqiptare, e bija e Seferit, e datëlindjes 19.02.1990, lindur në Poliçan dhe banuese në Tiranë në adresën Rr. Ylber Bykykbashi, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 034119269 dhe nr. Personal J05219003G

BLERËSI:

Lavdosh BALA, shtetas shqiptar, i biri i Hakiut, i lindur më 22.09.1954, në Vlorë, banues në adresën Lagjia 10 Korriku rruga Pirro Lala, Vlorë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën me Nr. BA5401920 dhe numër personal F40922043O.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Z. Renis Haxhia dhe Shoqëria Seman Sunpower janë ortak të shoqërisë Max Energy sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shiptar me nr. NIPT L77003205H, dhe dëshirojnë të shesin një pjesë të kuotën të zotëruar prej tyre në shoqërisë përkatësisht Z. Renis Haxhia do të shesë 4% të kapitali dhe Shoqëria Seman Sunpower do të shesë 3% të kapitalit, ndërsa blerësi Z. Lavdosh Bala kërkon të blejë kuotën që përfaqëson në tërësi 7% të kapitalit të shoqërisë.

Me vendimin e datës 14.10.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Max Energy sh.p.k u vendos shitja e masën 7% të kapitalit themeltar të shoqërisë Max Energy sh.p.k nga Ortaku Renis



Haxhia në masën 4% dhe Seman Sunpower në masën 3% të kapitalit, si dhe blerja e kësaj mase nga ana e blerësit të ri Z. Lavdosh Bala. Gjithashtu dhe vetë Ortaku Seman Sunpower nga ana e tij ka marrë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për shitjen e masës prej 3% të kapitalit të zotëruar në shoqërinë Max Energy, duke caktuar njëkohësisht dhe përfaqësuesin në këtë transaksion.

OBJEKTI

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.” në masën prej 7% të kapitalit themeltar, kuotë e cila zotërohet përkatësisht në masën 4% nga ortaku i shoqërisë Z. Renis Haxhia dhe në masën 3% të kapitalit nga ortaku shoqëria Seman Sunpower, me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga Z. Lavdosh Bala, në cilësinë e blerësit në këtë kontratë.

Shitja e kuotës së mësipërme, e cila përbën 7% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë “Max Energy sh.p.k.” sjell humbjen e së drejtës së pronësisë së ortakëve z. Renis Haxhia mbi 4% të kapitalit dhe shoqërisë Seman Sunpower mbi 3% të kapitalit të zotëruar në shoqëri. Si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, blerësi përfiton cilësinë e Ortakut të shoqërisë dhe pronësinë në masën 7% të kapitalit të shoqërisë.

KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN

Transferimi i së drejtës së pronësisë mbi kuotën do të jetë njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, struktura e kapitalit të shoqërisë tregtare “Max Energy sh.p.k”, do të jetë si më poshtë:

1. Z. Renis Haxhia, zotëron 1 (një) kuotë, në masën 48 % të kapitalit të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.”;
2. Z. Egi Santo zotëron 1 (një) kuotë, në masën 28 % të kapitalit themeltar të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.”;
3. Shoqëria Seman Sunpower sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, në masën 17 % të kapitalit themeltar të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.”;
4. Z. Lavdosh Bala zotëron 1 (një) kuotë, në masën 7 % të kapitalit themeltar të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.”.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS

Çmimi i këtij transaksioni shit – blerje kuote të shoqërisë të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.” do të jetë shuma prej 700 (shtatë qind) lek, vlera e kuotës të shoqërisë.



13919

Palët deklarojnë se e gjithë vlera e kësaj kontrate është paguar në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palët nuk do të kenë sot apo në të ardhmen asnjë pretendim mbi vlerën e shitjes.

DISPOZITA TË FUNDIT


Ligji i zbatueshëm është shqiptar. Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Kontrata hartohet në 5 kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

PALËT

SHITËSI

Renis HAXHIA



Seman Sunpower
Administratore

Orkida RAMA



BLERËSI

Lavdosh BALA

LAVDOSH BALA
B.B.